



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Publikimi Teknik - TP 31

Katalogu i pyetjeve të testit të njohurisë për operim me Sistem të mjetit ajror pa pilot (SAP)



Material udhëzues

Parathënie

Ky material udhëzues është i karakterit edukativ dhe ka për qëllim përgatitjen e kandidatëve të cilët i nënshtrohen pjesës teorike të testit të njohurisë për operim me Sistem të mjetit ajror pa pilot (SAP).

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) me datë 15 mars 2017, ka publikuar Rregulloren nr. 1/2017 për Sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Sipas kësaj Rregulloreje pronari ose operatori i SAP nga Kategoria 3 dhe 4 të duhet të jetë mbi 16 vjeç, i aftë nga ana mjekësore dhe të ketë kaluar testin e njohurisë mbi çështjet e adresuara me këtë Rregullore.

Kandidati duhet të paraqesë kërkesën me shkrim në AAC për t'iu nënshtuar testit të njohurive të Rregullores nr. 1/2017, dhe të paguajë një tarifë prej 25 € për Kategorinë 3 dhe 50 € për Kategorinë 4.

Testi i njohurive do të përmbajë pyetje të ndryshme dhe organizohet në ambientet e AAC-së. Kandidati kalon me sukses testin e njohurive, nëse iu është përgjigjur saktë të paktën 75% të pyetjeve. Poenët ipen vetëm për përgjigjet e sakta.

Nëse kandidati nuk e kalon testin e njohurive, ai/ajo mund të aplikojë për ri-testim, por jo pa kaluar 30 ditë nga testi i fundit i njohurive.

Kandidati i cili kalon me sukses testin e njohurisë, do të pajiset me një certifikatë përkatëse për një periudhë të pacaktuar, të lëshuar nga AAC-ja.

Ky doracak është përgatitur nga AAC si material udhëzues për rregullimin e kësaj fushe të aviacionit.

Nëse keni nevojë për informata shtesë, ju lutem të na shkruani në adresën e mëposhtme:

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Lagja Arbëria, Rruga Ahmet Krasniqi p.n.
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

e-mail: infocaa@caa-ks.org
drones@caa-ks.org

Tel: +383 38 248 629

Fax: +383 38 211 009

Eset Berisha
Drejtor i Përgjithshëm

Lista e faqeve efektive

| Titulli | Faqe | Ver. | Data efektive |
|---|---------|------|---------------|
| Parathënie | 2 nga 9 | 1 | 13.06.2019 |
| Lista e faqeve efektive | 3 nga 9 | 1 | 13.06.2019 |
| Tabela e aprovimit | 4 nga 9 | 1 | 13.06.2019 |
| Lista e distribuimit / Tabela e revidimit | 5 nga 9 | 1 | 13.06.2019 |
| Tabela e përmbajtjes | 6 nga 9 | 1 | 13.06.2019 |
| Pyetjet | 7 nga 9 | 1 | 13.06.2019 |

Tabela e aprovimit

| | Emri dhe pozita | Data | Nënshkrimi |
|-----------------------|--|-------------|-------------------|
| Përgatitur nga: | Leonora Ibraj Zyrtare për GAT | 15.03.2019 | |
| Autorizuar nga: | Kushtrim Musa Drejtore i DSF | 20.05.2019 | |
| Kontrolli i cilësisë: | Lendita Kika-Berisha Drejtore i DCS | 24.05.2019 | |
| Aprovuar nga: | Eset Berisha Drejtore i përgjithshëm | 13.06.2019 | |

Lista e distribuimit

| Kopje nr. | Vendndodhja | Media | Sasia |
|-----------|-----------------------------|------------|-------|
| 1 | Libraria e AAC-së | Origjinali | 1 |
| 2 | Serveri i dosjeve të AAC-së | Digjitale | 1 |

Tabela e revidimit

| Nr. Rev. | Datë | Përgatitur nga: | Autorizuar nga: |
|----------|------|-----------------|-----------------|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

Tabela e përmbajtjes

| | |
|---|---|
| Parathënie..... | 2 |
| Lista e faqeve efektive | 3 |
| Tabela e aprovimit | 4 |
| Lista e distribuimit / Tabela e revidimit | 5 |
| Tabela e përmbajtjes | 6 |
| Lista e pyetjeve | 7 |

Lista e pyetjeve

1. Për cilat lloje të Sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP) nuk zbatohet Rregullorja Nr. 01/2017?
2. Cilat mjete ajrore përjashtohen nga dispozitat e Rregullores Nr. 01/2017 bazuar në konventën e Çikagos të vitit 1944 dhe Ligjit Nr. 03/L-051 për aviacionin civil?
3. Çfarë nënkupton shkurtesa AAC?
4. Çfarë nënkupton shkurtesa “mjet ajror”?
5. Çfarë nënkupton shkurtesa ANP “Adem Jashari”?
6. Çfarë përcakton leja e KTA-së?
7. Operimi përtej vijës së drejtë të shikimit visual nënkupton?
8. Çfarë është hapësira e kontrolluar ajrore?
9. Çfarë nënkupton hapësira për fluturimin me SAP?
10. Vija e drejtë vizuale nënkupton?
11. Në sa kategori ndahen aktivitetet me SAP?
12. Ju lutem përshkruani kategorinë 2 të operimeve me SAP?
13. Një SAP me peshë operative nga 20kg deri në 150 kg, hynë në cilën kategori?
14. Në sa klasë ndahen hapësirat e fluturimit me SAP?
15. Ju lutem përshkruani klasën e I-rë të hapësirës së fluturimit me SAP?
16. Ju lutem përshkruani klasën e II-të të hapësirës së fluturimit me SAP?
17. Ju lutem përshkruani klasën e III-të të hapësirës së fluturimit me SAP?
18. Ju lutem përshkruani klasën e IV-ët të hapësirës së fluturimit me SAP?
19. A duhet të mbajë kontakt visual të drejtpërdrejt pronari/operatori me SAP?
20. A duhet të mirëmbahet SAP para operimit?
21. Para operimit me SAP pronari/operatori është përgjegjës për?

22. A mund të bartni mallra me SAP?
23. A lejohet mbledhja dhe përdorimi i imazheve të objekteve qeveritare me SAP?
24. Cili është roli i Policisë së Kosovës dhe KFOR-it në zbatimin e Rregullores nr. 01/2017?
25. A nevojitet aprovimi i AAC-së për operime me SAP?
26. Për çfarë afati kohor është valid aprovimi i AAC-së?
27. Sa orë/ditë paraprakisht duhet të dorëzohet/dërgohet kërkesa për operim me SAP te SHINA?
28. Cila është distanca minimale e operimit me SAP nga ANP "Adem Jashari"?
29. Cila është distanca minimale e operimit me SAP nga bazat ushtarake të NATO's?
30. A mund të operoni gjatë natës me SAP?
31. Cila është distanca minimale e operimit mbi tubimet e njerëzve me SAP?
32. Cila është lartësia maksimale e operimit mbi lartësinë e tokës me SAP?
33. A duhet të regjistrohet SAP?
34. A ju nevojitet polica e sigurimit ndaj palëve të treta për të operuar me SAP?
35. Sa është përqindja e përgjigjeve të sakta të cilat ju nevojiten që të kaloni me sukses testin e njohurisë?
36. Pas sa dite mund ti nënshtroheni testit të njohurisë nëse nuk e kaloni me sukses testin e parë?
37. Cili Ligj përcakton masat ndëshkuese për shkeljen e dispozitave të Rregullores nr. 01/2017?